



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 31 maj 2019, në mbledhjen e XX (njëzet) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës (Lista e nënshkrimeve), përveç znj.Fatlume Jaha e cila mungoi,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OJQ-ve lokale (Rrjet i OJQ Lokale), përfaqësues të mjeteve të informimit dhe mediave, dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, i njoftoj rreth pikave të rendit të propozuar të ditës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së. Gjithashtu Kryesuesi njoftoj për mungesën e paralajmëruar të këshilltares znj.Fatlume Jaha.

Në ftesë të Kryesuesit të Kuvendit, nga të pranishmit u mbajt një minutë heshtje në nderim të Dëshmorit të Kombit Ali Agëti, me rastin e 30 vjetorit të rënies.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoj punimet, theksoi, para se të fillojmë me rendin e ditës, nëse ndokush dëshiron të marr fjalën urdhëroni nëse jo, e vë në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë të rekomanduar nga KPF.

z.Fatmir Rudari, theksoi, kërkoj që këtij rendi të ditës t'i shtohet edhe një pikë e cila ka të bëjë me garën e diturisë në Komunën e Podujevës. Siç e dimë të gjithë, më 11 maj 2019 ishte caktuar që të mbahet gara e diturisë në të gjithë Kosovën dhe kjo garë ishte caktuar të mbahet edhe në Komunën e Podujevës. Edhe pse të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit i janë përgjigjur kësaj gare, dhe pas pritjeve të gjata nuk janë sjell testet nëpër shkolla. Andaj kërkoj që të futet si pikë shtesë e rendit të ditës, mirëpo meqë Drejtori i Drejtorisë së Arsimit nuk qenka prezent, mund ta përkrahim si rekomandim që pika në fjalë të përfshihet në kuadër të rendit të ditës në mbledhjen e radhës të Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju informoj se Drejtori i Drejtorisë së Arsimit nuk prezent sot në këtë mbledhje për arsye se sot është testi i arritshmëris dhe ai kërkohet të jetë prezent në shkolla. Po ashtu meqë material të gatshëm nuk kemi për këtë çështje, a pajtoheni që për pikën e kërkuar të informohemi në seancën e radhës.

Njëzëri u pajtuan që pika e kërkuar nga këshilltari z.Fatmir Rudari, të përfshihet në rendin e ditës në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, e hedhi në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar së bashku me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa, duke përfshirë edhe pikën shtesë:

- *Propozim vendimin për vëni në diskutim publik të:*
 - *Propozim Rregullore për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës*
 - *Propozim Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës*

E cila hyn në pikën 4, kurse pika Të ndryshme kalon në pikën

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 08 maj 2019

Njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 08 maj 2019

2. Informatë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, lidhur me punimet në rrugën “Zahir Pajaziti”

z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, lidhur me këtë çështje ne edhe në mbledhjet e kaluara kemi biseduar, mirëpo këshilltari z.Arbër Blaku ka kërkuar të ketë një informatë rreth projektit në fjalë dhe tani ju është paraqitë kjo informatë të cilën keni pasë kohë të mjaftueshme ta lexoni dhe analizoni, përkatësisht rreth ndërtimit të rrugës në fjalë, ndërtimi i të cilës është planifikuar të ndërtohet apo të themi është projekt dy vjeçar, pra brenda këtij afati duhet të përfundoj, konkretisht brenda vitit 2019.

Gjatë punimeve të kësaj rruge ne kemi të përfunduar kanalizimin fekal, kanalizimin atmosferik dhe ujësjellësin, kurse tani ka mbete vetëm shtrirja e rrjetit energjetik, dhe në këtë fazë që jemi para 4 dite kemi bërë mbylljen e një pjese të asaj rruge për shkak se është e pamundur që të kryhen punime përderisa bëhen lidhje tërthorazi në rrjetin nëntokësorë të kanalizimit fekal edhe të ujësjellësit, lidhje këto të cilat po bëhen të veçanta duke përfshirë edhe lidhje të energjisë elektrike. Këto punime planifikohen të përfundojnë për një muaj e dy javë, natyrisht duke përfshirë komplet infrastrukturën që është në atë pjesë. E di që është shqetësim edhe për qytetarët edhe për bizneset që janë në atë pjesë por ne do të bëjmë maksimumin e mundshëm. Edhe pse është e mbyllur rruga, një pjesë është e lirë për qytetarë që të lëvizin, ndërsa për biznese ne e kemi menduar dhe kemi lejuar qasje, përkatësisht i kemi njoftuar Policinë edhe kompaninë punë kryese që në atë pjesë mund të lëvizin bizneset.

Marrë parasysh edhe muajin e Ramazanit ne e kemi shty deri tash punimet në mënyrë që të mos dëmtohen bizneset, e them këtë sepse siç jemi në dijeni bizneset duan të kenë sa më shumë frekuentim të qytetarëve.

Unë jam shumë i bindur se shumë shpejt edhe rruga në fjalë do të përfundon. Po ashtu edhe me bizneset që operojnë në atë pjesë kemi biseduar dhe jam në kontakt çdo herë ashtu siç jam i gatshëm në maksimum t’iu vijmë në ndihmë kërkesave të tyre që mund të kenë.

Gjithashtu dëshiroj t'ju informoj se rruga në fjalë do të bëhet rrugë moderne, me tri korsi, ngase nuk ka hapësirë më shumë, dhe do të jetë një rrugë me standard, ashtu siç do të jenë edhe rrugët tjera të planifikuara për ndërtim në vitin 2021, ngase në vitet 2019 dhe 2020 e kemi ndërtimin e Sheshit të qytetit, andaj posa të përfundoj ky projekt, në vitin 2021 do të vazhdojmë tërë aksin e rrugës “Skënderbeu” e cila po ashtu do të ketë infrastrukturë nëntokësore e që jemi rënë në dakord edhe me KEDS-in edhe me Ujësjetellësin dhe me Kompanitë tjera që në qendër të qytetit dhe në pjesën urbane të qytetit më nuk do të ketë shtylla elektrike, nuk do të ketë më tela mbi tokë që edhe e pengojnë komunikacionin edhe qytetarët. Prandaj besoj që tani e tutje Podujeva do të merr një kahe të një pjese urbane moderne.

Pastaj dëshiroj t'ju njoftoj edhe rreth Hartës Zonale, dokument të cilin jemi shumë afër përfundimit si draft të parë dhe besoj që në mbledhjen e ardhshme do ta sjellim si draft Hartën Zonale, me qëllim të hapjes së mundësive për diskutime publike në mënyrë që muajin gusht të përfundoj si proces.

z.Arbër Blaku, theksoi, i nderuar Drejtor i DPUMM, në seancën e kaluar e potencove që projekti është dy vjeçar, unë çka hulumtova në bazë të materialit, kontrata me kompaninë është një problem goxha i madh, dua të them se kontrata është në korrik dhe është dashtë të përfundojnë punimet me 15 maj 2019, kurse ne tani veç e dim se ka kaluar kjo datë, andaj për këtë çështje që e ceka është mirë të japësh sqarim shtesë, përkatësisht a doni të vëni edhe një projekt të ri apo çka doni të bëni. Kontrata ju ka jap kompanisë me 1 milion e diçka euro, dhe nuk është kryer puna me 15 maj, andaj a dëshironi të vendosni penallti për atë Kompani apo përse keni lejuar që pas 15 majit Kompania përkatëse të vazhdoj me punë, e që sipas asaj që po shohë unë në terren ende as 50% e punëve nuk janë kryer në rrugën “Zahir Pajaziti”.

Çështja tjetër, planifikimi i rrugëve që e keni bërë ju sidomos këtë “Zahir Pajaziti” a i keni pyetur bizneset, dhe a keni shikuar ndonjë formë se si të mbyllni atë rrugë, në fakt keni mbyllë rrugën prej Interex-it deri te Hotel Besiana, por është dashtë të rregulloni të paktën bile rrugën “Vëllezërit Frashëri” dhe atë “Ali Ajeti” në mënyrë që të kenë qasje më të lehtë në qytet edhe bizneset edhe qytetarët e asaj pjese. Sigurisht jeni në dijeni që rruga afër Interex-it është në gjendje shumë të keqe, pastaj edhe rruga prej tjegullores deri te “Vëllezërit Frashëri” është po ashtu në gjendje shumë të keqe, andaj është deshtë paraprakisht t'i rregulloni rrugët në mënyrë që ta mbyllni aksin kryesor të qytetit, çështje kjo e cila paraqet diçka të pa imagjinueshme për mua. Pastaj kemi çështjen tjetër, jemi afër festës së Bajramit dhe mbyllja e asaj pjese të rrugës “Zahir Pajaziti” është dashtë të shtyhet të paktën edhe për një javë sepse për këtë festë vinë edhe gurbetqarët si dhe është unaza kryesore e qytetit që lidh qendrën andaj mendoj se nuk është dashtë që në këtë kohë të mbyllet dhe të fillohet me punime. Pra duhet të kemi mirëkuptim për ata njerëz të cilët në një formë mund të them se po na mbajnë gjallë, por edhe për bizneset që operojnë në atë rrugë të cilët pothuajse i keni paralizuar totalisht.

Në raportin e fundit që kemi marrë, kemi hasë në shumë probleme si kanalizim, gypa të ujit, kanalizimit, rrymës, etj, çështje për të cilat mendoj që kur është bërë projekti, është dashtë që kompanisë me i vë kritere që me i pas pajisjet sepse jemi në vitin 2019, duhet të dihen se ku janë gypat e ujit, kanalizimit, rrymës, internetit etj. Pra kjo është një mos planifikim i mirë nga ana juaj Drejtor, nuk e kam personalisht me sepse jemi duke diskutuar për punën e Komunës, jom për ara të babës. Unë kam pas jashtëzakonisht shumë kërkesa prej komitetit që banojnë në rrugën “Zahir Pajaziti” madje lidhur me këtë problematikë kam një propozim për Kuvendin, për shkak se në vitin 2019 aq shumë janë bërë dëme në atë rrugë, sa që unë propozoj që Kuvendi Komunal të shikoj format dhe të marrë një vendim, që ato biznese që operojnë në atë rrugë, për vitin 2019 t'i lehtësojmë diçka, qoftë në taksë apo ndonjë lehtësirë tjetër, pra është mirë ta diskutojmë ne si

Kuvend këtë çështje që bizneseve që janë në rrugën “Zahir Pajaziti” t’iu bëjmë një lehtësim në taksa ose diçka tjetër ngase punimet kanë ndikua direkt në punën e tyre.

z.Fitim Haziri, theksoi, të them të drejtën atë ditë kur e pash gatishmërinë e Drejtorit të DPUMM për të na informuar lidhur me rrugën thash kemi me pas një material voluminoz edhe ka me qenë e vështirë të përpunohet të tërin, por kur e pashë që shumica e informatës ishte vetëm foto, për neve si LVV kjo informatë është jo e plotësuar ashtu qysh duhet sepse i mungojnë shumë elemente. Meqenëse po bëhet fjalë për rrugën “Zahir Pajaziti” është dashtë të futet edhe ajo se çfarë është bërë në këtë rrugë më herët, ende pa u bë dy vite, në 2017 po në këtë rrugë në kohë fushate, në mënyrë të jashtë ligjshme është bërë rikonstruimi dhe asfaltimi i kësaj rruge në vlerë prej 155.493,52 €, se është projekt i jashtë ligjshëm nuk ka dyshim këtë e dëshmon edhe përgjigjja zyrtare të cilën e kemi marrë prej Kryesuesit të Kuvendit ku nga i cili kemi kërkuar vendimin e Kuvendit rreth projektit në fjalë dhe si përgjigje kemi marrë, po e citoj ashtu si e kemi marrë përgjigjen, *sa për sqarim pas konsultimit me Drejtorin e Buxhetit dhe Financave projekti për asfaltimin e rrugës “Zahir Pajaziti” është bërë nga kodi buxhetor 44621 ku dhe parashihet asfaltimi si kategori*. Në kodin buxhetor 44621 gjendet projekti zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Zahir Pajaziti” dhe “Skënderbeu” së bashku me gjithë infrastrukturën përcjellëse, pra në emër të këtij projekti ju keni bërë rikonstruimin e rrugës “Zahir Pajaziti” në vitin 2017, projekt mbi projekt e që është e jashtë ligjshme. Kam një pyetje për Kryetarin, por meqë nuk është si gjithë herë, atëherë e kisha pyet Nënkryetarin apo Drejtorin e DPUMM, pse e keni bërë asfaltimin e rrugës “Zahir Pajaziti” në vitin 2017 pa vendim të Kuvendit dhe e keni dëmtuar buxhetin e Komunës, paratë e qytetarëve, taksapaguesve të Republikës së Kosovës në vlerë prej 155.493,52 €. Pastaj do të shtroj edhe një pyetje, cili prej jush do të kishte investuar në një projekt me paratë e veta 160,000.00 € kur e kish ditë që ende pa u bërë dy vite duhet të shkatërrohej. Tani me fillimin e punimeve në këtë rrugë keni filluar ta heqni asfaltin, kam një pyetje për Drejtorin e DPUMM, pse po e heqni asfaltin kur Kryetari yt ka thënë që ky asfalt nuk do të hiqet. Pyetja tjetër që e pasuron këtë informatë, pse është bërë implementimi i projektit të kanalizimit fekal dhe atij atmosferik në rrugën “Zahir Pajaziti” që e përfshin rrugën nga Pranvera deri te rruga “Skënderbeu” dhe a është i përfshirë në planifikimin e prokurimit, ku është marrë vlera e parashikuar e kontratës në vlerë prej 154.470.10 € kur dihet se për këtë projekt në buxhetin e vitit 2018 është planifikuar buxhet në vlerë prej 900.000,00 €. Qëllimi i korruptuar në këtë aktivitet të prokurimit ku kanë marrë pjesë dy operator ekonomik që është Toifor në vlerë prej 108.530,37 € dhe Bini në vlerë 151.983,14 €, ku diferenca në mes të këtyre dy operatorëve është 43.452,77 €, pra për këtë shumë është dëmtuar buxheti i taksapaguesve të Podujevës, ku është prokuroria në këtë rast që me të vërtetë ish dashtë që të merrej që moti me këto gjëra.

Sa i përket informatës që e paraqiti Drejtori nuk po merrna fort me të, besoj që flasin tjerët, unë po e përfundoj, ashtu siç e ka përfunduar informatën Drejtori, me një foto të fundit dhe këtu e kisha cek që është struktura më e lartë e keqpërdorimit të taksapaguesve dhe qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, ne si subjekt i Partisë së Drejtësisë e kemi përcjell vazhdimisht punën në rrugën “Zahir Pajaziti” si rrugë kryesore, sigurisht që është shumë e ngarkuar me infrastrukturën e vjetruar nëntokësore dhe mbitokësore, dhe si e tillë në shumë raste ka qenë edhe pengesë për zhvillimit normal të punimeve, megjithatë ne kërkojmë nga Drejtoria përkatëse që të intensifikohen punimet dhe të vazhdojnë me një ritëm më të shpejtë të punës për arsye se në atë rrugë janë shumë biznese dhe veprimtari të tjera për të cilat zvarritja e këtyre punimeve është dëmtuese për ta. Gjithashtu, gjatë sezonit veror ardhja e mërgimtarëve e rritë numrin e pjesëmarrësve në komunikacion, bllokimi i kësaj rruge në afat më të gjatë do të thotë mbi ngarkim i rrugëve tjera

alternative. Presim që me përfundimin e punimeve në këtë rrugë që nënkupton edhe zgjerimin e saj të kemi lehtësi më të madhe të zhvillimit të komunikacionit.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, do ti përgjigjem z.Arbër Blakut, ne i kemi dy rrugë alternative për momentin, rrugën “Ali Ajeti” për ata që vijnë nga pjesa e Merdarit dhe pjesa e Shajkocit, pastaj kemi hyrjen nga Prishtina përkatësisht nga vendi i quajtur qershia e Llapashticës që mund të futen në Podujevë, pjesën që është si unazë e vogël tek rruga “Vëllezërit Frashëri”, andaj nuk e di çka është dashtë të ndërtojmë për shkak se ajo rrugë në të ardhmen do të rikonstituohet sikurse rruga “Zahir Pajaziti”. Në atë pjesë ne jemi në dijeni që ka shpërthim të gypave nganjëherë si dhe e dimë që nuk rregullohet brenda dite sepse përgjegjëse për këtë është Kompania e Ujësjellësit edhe pse ne i bëjmë trysni të madhe që të përfundoj më shpejtë, andaj besoj që ajo sot, nesër tejkalohet.

Këshilltari z.Fitim Haziri e paraqiti një fotografi, mirëpo ajo foto është, nuk di çfarë t’i them dhe se nuk e kam ndërmend të përlohem me të individualisht, mirëpo pyetja dhe fjala korrupsion apo keqpërdorim është jashtëzakonisht e rëndë. Ne jemi duke bërë më të mirën që është e mundshme, unë projektin në fjalë nuk e kam zhvilluar sepse ai projekt është bërë para 3-4 viteve dhe është projekt i një niveli më të mirë, po ta shikoni si projekt, por edhe realizimi që do të bëhet sipas projektit besoj që do të bëhet në nivelin e duhur. Sa i përket pjesë së dytë që e ceku këshilltari në fjalë, kemi të bëjmë vetëm me sanim sepse kemi gropë të shumta nëpër rrugë, madje kemi edhe sanime tjera të tilla, shembull, kemi rrugën 500 m, për Shajkoc që është dashtë t’i sanojmë ngase po të hyjmë të rregullojmë vetëm gropat, nuk është sanim apo të themi zgjidhje e duhur, por është dashtë të shtrojmë një shtresë të hollë të asfaltit, prandaj i nderuar ajo çfarë potencove ti tani janë bërë afër 3 vite, dhe në atë kohë edhe pse nuk kam qenë Drejtor unë e them që ka qenë vetëm çështje e rikonstruimit, madje jo vetëm e asaj rruge por edhe disa rrugë tjera të cilat iu mundësojnë qytetarëve lëvizje më të mirë.

Sa i përket çështjes së bizneseve që zotëri Blaku e ngriti, ne kemi biseduar edhe jam i gatshëm të bisedoj çdo herë me qëllim të zgjidhjes së problematikave të ndryshme eventuale, mirëpo edhe pse është mbyllë rruga në fjalë, bizneset nuk e kanë asnjë pengesë deri në atë pjesën ku mund të depërtojnë deri sa të vie pjesa lartë e që me shpejtësi të madhe do të bëhen edhe depërtime tërthorazi që lidhen me rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit. Sigurisht jemi në dijeni që sidomos në rrjetin e ujësjellësit ka instalime ilegale të cilat e kanë dëmtuar shumë gypin kryesor edhe pse ka qenë i vjetër, andaj është deshtë të eliminohet sepse ka mund të jetë edhe kancerogjen, prandaj kemi vendosë gypin e ri i cili më nuk do të mund të shpërthehet nga qytetarët për kyçe por do të vendosen puseta të caktuara për lagje të caktuara.

z.Arbër Blaku, theksoi, i nderuar Drejtor, unë e kam parë raportin e ujësjellësit për rrugën “Vëllezërit Frashëri”, ata thonë që ka përfunduar kyçja e atij segmenti. Pra po diskutojmë për gyp të ujit edhe asfalt, asgjë më shumë.

z.Fitim Haziri, theksoi, unë paraprakisht shtrova pyetje Drejtorit të DPUMM i cili nuk pati çfarë të thotë por iu iku pyetjes dhe u kap te fotoja. Pastaj nuk e thash unë fjalën korrupsion por e thash keqpërdorues. Sa i përket projektit të sanimi i gropave është e vërtetë dhe pajtohem me ty që ka qenë në projekt në vitin 2018 edhe kemi kërkuar qasje në dokumente zyrtare sa është sanimi i gropave në qytet, kemi kërkuar në dokumente zyrtare ta dijmë në cilat rrugë është bërë sanimi i gropave në qytet sepse dyshohet që është edhe rruga “Zahir Pajaziti” dhe nuk na është dhënë përgjigje, ndërsa ti Drejtor po thua që është bërë sanim, nuk është bërë sanim por është rikonstruim i rrugës “Zahir Pajaziti”, pra nuk po thotë sanimi por rikonstruimi dhe asfaltimi që është projekt mbi projekt, është pa vendim të Kuvendit Komunal dhe është i jashtë ligjshëm.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, theksoi, është e vërtetë që secili riparim apo secila punë që zhvillohet, në ato pjesë fushën e biznesit e dëmtojnë. Taksa komunale është shumë simbolike, administrata tatimore duhet me pasë parasysh që në këtë periudhë kohore sa është rruga e mbyllur nuk duhet të tatimohen veç që duhet të lajmërohen në administratën tatimore. Përveç kësaj mendoj që duhet t'i bëhet thirrje kompanisë punëkryese që ti kryej punimet sa me shpejt të jetë e mundur, kjo është ndihma ma e madhe që duhet për bizneset.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket punimeve, ne mund të kontaktojmë të gjitha kompanitë dhe bizneset, dhe të bëjmë një shkresë në ATK, pastaj të shikojmë a ka mundësi t'iu ndihmojmë bizneseve sa i përket mos tatimit sepse nuk varet krejt kjo çështje nga ne, mirëpo çka është taksë e jona ne mund ta diskutojmë në Kuvend, dhe nuk ka kurrfarë problemi, por sa i përket taksave në ATK-s si institucion qendror ne nuk kemi mundësi, por vetëm mundemi të bëjmë një shkresë për shkak të rrugës që është, përndryshe krejt varet prej ATK-s, ndërsa për taksat tona është çështje e Kuvendit tonë. Çfarë mundemi të ndihmojmë bizneset ne do të ndihmojmë.

z.Arbër Blaku, theksoi, i nderuar Drejtor, nuk thash unë për ATK-në, unë fola për shpinë tonë për Komunën që të bëjmë një lehtësim si kërkim falje për ato biznese se ajo vlerë nuk është e madhe, rreth 150 apo 200 € është taksa vjetore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet rreth kësaj teme përfunduan, u jepen sqarimet dhe informatat e nevojshme ndaj shqetësimeve dhe çështjeve tjera të ngritura, andaj e konstatoj të mbyllur këtë temë dhe vazhdojmë me punë me pikat e radhës.

3. Rishqyrtimi i Vendimit me nr.prot.01-060/01-0030178/19

-Shkresa e Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal, nr.pro.020-253/8

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me një vendim për të cilin sigurisht jeni në dijeni si dhe kur është marrë nga ana e këtij Kuvendi, i cili pastaj është dërguar në Ministrinë përkatëse për shqyrtim të ligjshmërisë përkatësisht vlerësimin e ligjshmërisë së atij vendimi, dhe tani kemi një vlerësim nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL përmes shkresës së cekur ku thuhet se akti në fjalë është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ashtu siç keni mund të shihni të gjithë në materialin që ju është dërguar, njëherit sipas shkresës në fjalë është sugjeruar që vendimi të harmonizohet me ligjin për energji elektrike, e që t'ju them të drejtën ne kemi kërkuar dhe analizuar këtë ligj por nuk kemi mund të gjejmë askund ndonjë dispozitë adekuate në mënyrë që të bëhet harmonizimi. Afati i rishqyrtimit të vendimit sipas shkresës së MAPL-së, është 30 ditë nga dita e marrjes së shkresës dhe ne duhet të ndërmarrim hapat e nevojshëm.

Në këtë kontekst, lus të gjithë që me rastin e vendosjes për dokumente të ndryshme, të mos ketë ngut, të mos ketë propozime për të cilat nuk jemi të përgatitur si Kuvend, dhe iniciativat e ndryshme të jenë të bazuara në ligje dhe akte tjera nënligjore në mënyrë që mos të marrim vendime të cilat pastaj dalin të jenë të kundërligjshme, dhe si rrjedhojë të dalim jo serioz, sikurse që kemi këtë rast. Andaj e hapi diskutimin rreth kësaj.

z.Bajram Ajeti, theksoi, tashmë është e njohur për çdo administratë dhe profesionist që merret me çështje juridike që një vendim apo akt administrativ duhet të ketë tri elemente kryesore që është hyrja-baza ligjore, dispozitivi dhe pastaj arsyetimi i atij akti, çështje të cilën e rregullon Ligji për procedurën e përgjithshme administrative, por që fatkeqësisht na kthehet një vendim për arsye se

nuk është arsyetuar në bazën juridike. Është marrë për bazë Ligji për vetëqeverisje lokale mirëpo çështja apo fusha e cila është dashtë të trajtohet kanë qenë edhe ligjet e veçanta të cilat e rregullojnë çështjen e energjisë elektrike, shpenzimin e saj por edhe konsumatorët, prandaj mendoj se këto lëshime dhe këto gabime nuk mund të bëhen dhe duke marrë parasysh shkresën të cilën e ka dërguar MAPL-ja se akti në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe i njëjti të rishikohet, unë mendoj se kanë të drejtë, por edhe vendimi që është marrë është i drejtë, për këto arsye, sepse Kuvendi i Komunës ka nxjerrë vendimin që Kompanisë KEDS ti ndalohet vendosja e njehsorëve për matjen e energjisë elektrike në shtylla të rrjetit elektrik në hapësira publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës. MAPL, pas shqyrtimit të përmbajtjes së këtij vendimi ka vlerësuar se akti i Komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi për shkak se vendimi i Komunës nuk ka cekur bazën ligjore mbi të cilën mbështetet dhe arsyetohet vendimi në fjalë, dhe ka rekomanduar që vendimi duhet të nxirret në përputhje me ligjin e aplikueshëm për energji elektrike i cili ndër të tjera përcakton edhe të drejtat e konsumatorëve të energjisë elektrike. Gjithashtu MAPL ka kërkuar nga organet komunale që të bëjnë harmonizimin e vendimit me dispozitat ligjore në fuqi, dhe atë brenda 30 ditësh, afat ky i cili fillon nga data e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim.

Kuvendi i Komunës ka marrë vendim për ndalimin e vendosjes së njehsorëve të energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësira publike, për arsye se një vendosje e tillë cenon të drejtat e konsumatorëve të energjisë elektrike në Komunën e Podujevës dhe njëkohësisht cenon edhe të drejtat themelore të njeriut. Në nenin 119 paragrafi 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e garantuar mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me ligjin, pra të drejtat e konsumatorëve janë të drejta Kushtetuese që mbrohen me ligj, pastaj të drejtat e konsumatorëve janë të rregulluara edhe me Ligjin nr.06/L-34 për mbrojtjen e konsumatorit, neni 2 paragrafi 2, përcakton se ky ligj zbatohet për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet konsumatorëve nga njëra anë dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve dhe ofruesve të shërbimeve në anën tjetër, për ta mbrojtur konsumatorin nga praktikat e padrejta në tregun e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Kosovës. Pastaj në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi 29 të Ligjit të cekur, si shërbime publike përkufizohet, ndër të tjera edhe shpërndarja edhe furnizimi me energji elektrike, mandej ky Ligj për mbrojtjen e konsumatorit në nenin 4 ka përcaktuar disa të drejta themelore të konsumatorit, prej të cilave veçojmë; të drejtën për të mbrojtur jetën, shëndetin, mjedisin dhe interesat ekonomike të konsumatorit, të drejta këto të cilat njëkohësisht përbëjnë të drejtat themelore të njeriut, të parashikuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të gjitha instrumentet ndërkombëtare. Është detyrim pozitiv i autoriteteve të pushtetit shtetëror që të garantojnë të drejtat themelore të njeriut, neni 21 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton, Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat themelore të njeriut të parashikuara në këtë Kushtetutë, çdo kush ka për detyrë të respektoj të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Mandej Ligji për mbrojtjen e konsumatorit, neni 24 paragrafi 2 obligon ofruesit e shërbimeve publike që t'ju sigurojnë shërbime konsumatorëve duke marrë parasysh ndër të tjera edhe sigurinë, e që në këtë rast KEDS ka për detyrë. Vendosja e njehsorëve për matjen e energjisë elektrike në shtylla të rrjetit elektrik në hapësira publike cenon sigurinë e qytetarëve duke pasë parasysh që në disa vendbanime të Komunës së Podujevës, njehsorët janë vendosur në lartësi të mëdha, konkretisht në majë të shtyllave të rrjetit elektrik ku konsumatorët e kanë të vështirë dhe të rrezikuar qasjen në të dhënat e konsumatorit nëse ata dëshirojnë të vërtetojnë përputhjen e të dhënave me njehsorët me të dhënat e konsumit të energjisë elektrike që figurojnë në faturat e tyre, ndërsa në disa vendbanime të Komunës së Podujevës, njehsorët janë vendosur poshtë në shtylla elektrike, vendosja e tillë është e rrezikshme duke pasur parasysh që njehsori është lehtësisht i qasshëm nga personat e pandërgjegjshëm dhe persona të tjerë siç janë fëmijët të cilët lehtësisht mund t'i dëmtojnë njehsorët

dhe gjithashtu mund të dëmtojnë shëndetin e tyre duke kryer veprime të tilla. Dallimi i vendosjes së njehsorëve diku në maje të shtyllave e diku poshtë, me të drejtë ka shkaktuar pakënaqësi tek qytetarët – konsumatorët të cilët janë shqetësuar për pabarazi dhe jo transparencë.

Obligimet ndaj ofruesve të shërbimeve publike gjithashtu rregullohen me Ligjin nr.05/L-085 për energjinë elektrike, ku neni 5 përcakton, që ndërmarrjeve përkatëse për energji duhet t’iu caktohen obligime lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit. Ndërmarrja private KEDS nuk e ka respektuar këtë dispozitë me rastin e vendosjes së njehsorëve në shtylla elektrike pasi që me këto veprime nuk ka marrë parasysh sigurinë e qytetarëve. Ligji për energjinë elektrike, neni 38 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 përcakton obligimin për furnizuesin e energjisë elektrike që të faturoj energjinë elektrike në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, pastaj ky Ligj në nenin 48 përcakton të drejtën e konsumatorit që të ketë në dispozicion të dhënat e konsumit të tij si dhe përcakton që konsumatori nuk ngarkohet me shpenzime shtesë për këtë shërbim, qasjen në të dhënat e konsumit. Në kundërshtim me këtë dispozitë vendosja e njehsorëve në maje të shtyllave të rrjetit të energjisë elektrike ka cenuar të drejtën e konsumatorit që të ketë në dispozicion të dhënat e konsumit të tij dhe ka cenuar transparencën dhe mos diskriminimin në faturimin e energjisë elektrike, kjo për arsye se shkak u i pozitës së vështirë të njehsorit konsumatori nuk ka mundësi të ketë qasje në të dhënat e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe për të kontrolluar një gjë të tillë i duhet të bëjë shpenzime shtesë, andaj në këtë mënyrë është cenuar edhe dispozita e nenit 53 paragrafët 5 dhe 6 të Ligjit për energjinë elektrike në të cilin përcaktohet detyrimi që konsumatorit t’i ofrohet qasje në të dhënat e qasjes së konsumit.

Të drejtat e konsumatorit në lidhje me matjen e konsumit rregullohen gjithashtu edhe me kodin e matjes së OSSH-së, ku parimet për të rëndësishme të këtij kodi janë të përcaktuara në pikën 2.1.3, ku ndër të tjera përcaktohet që njehsorët e instaluar dihet të jenë të sigurt dhe të kenë qasje të lehtë për tu lexuar dhe mirëmbajtje nga OSSH. Pastaj pika 5.2 2 kodit të matjes përcakton personelin që janë qendra e kontrolleve, operatori i transmisionit etj etj, pastaj konsumatori, çdo person tjetër që përkon me fjalë ka marrëveshje për furnizim me energji elektrike te konsumatorët. Përveç këtyre, vendosja e njehsorëve në shtylla elektrike siç është bërë në disa vendbanime të Komunës së Podujevës bënë të mundur qasjen e personave të paautorizuar në njehsorët e matjes me ç ‘rast të dhënat e njehsorëve mund të keqpërdoren, të dëmtohen apo të asgjësohen. Kjo shkakton cenimin e të drejtës së privatësisë si e drejtë themelore e njeriut e parashikuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 36.

Mbrojtja e konsumatorëve të energjisë elektrike rregullohet gjithashtu me rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike.

Kështu që të nderuar, baza ligjore shihet se është dhe e mbron konsumatorin dhe realisht veprimet e bëra nga KEDS i konsiderojmë se janë të kundërligjshme, prandaj për të mbrojtur vendimin e asamblesë Komunale të Podujevës, me gjithë këtë bazë ligjore, një vendimi të tillë që ka qenë paraprakisht dhe që është konsideruar antiligjor, ne e japëm bazën ligjore të cilën njëkohësisht e arsyetuar mjaft besoj, dhe i njëjti vendim të dërgohet dhe të mbrohet konsumatori dhe të mbrohet qytetari.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket kësaj pike që ka të bëjë me rishqyrtimin e vendimit nga një prej mbledhjeve të kaluara për ndalimin e vendosjes së njehsorëve elektrik në shtylla elektrike, për shkak të kthimit të përgjigjes nga MAPL si vendim i jashtëligjshëm, dëshiroj të diskutoj për dy çështje.

Rreth vendosjes së njehsorëve në shtylla elektrike për momentin kemi një vendim sipas të cilit KEDS vazhdon punën, vendim i cili është lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM dhe që i lejon KEDS-it vendosjen e njehsorëve elektrik në shtylla, mirëpo

nuk është e specifikuar decidivisht se ku të vendosen, lartë apo poshtë në shtylla, vendim i cili është në fuqi dhe sipas të cilit punohet edhe sot, madje rreth 2 ditë më parë kam qenë në fshatin Peran dhe pash duke u vendosur njehsorë lartë në shtylla. Për tu shfuqizuar ai vendim duhet të merret një vendim tjetër sepse dy vendime të ndryshme për një çështje nuk mund të jenë.

Çështja tjetër është se MAPL, vendimin e Kuvendit të Komunës të miratuar në propozim të subjektit LVV, e ka kthyer të jashtëligjshëm për shkak të mos harmonizimit të pikës 2 të vendimit në dispozitë ligjore, dhe në fund të shkresës së MAPL-së citohet, bazuar në të cekurat më lartë, vendimi i Komunës nuk ka cekë bazën ligjore mbi të cilën mbështetet dhe arsyetohet vendimi në fjalë, neni 2 i vendimit i cili si arsyeshmëri cekë shkeljen e të drejtave elementare të njeriut që është siguria dhe transparenca në qasje dhe gjendje të shpenzimeve elektrike, njehsorët elektrik, por nuk përmban ndonjë dispozitë ligjore materiale mbi të cilën kjo e drejtë është e garantuar, dhe në këtë drejtim MAPL konsideron se vendimi në fjalë duhet të nxirret në përputhshmëri me ligjet e aplikueshme për energji elektrike i cili ndër të tjera përcakton edhe të drejtën e konsumatorëve në energjinë elektrike. Bazuar në këto, MAPL kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës që të ndërmerren veprime konkrete që aktin e Komunës ta harmonizoj në dispozitë ligjore, pra kjo çështje nuk është kërkuar nga LVV-ja apo ndonjë subjekt tjetër politik, andaj unë po bazohem në këtë dokument (shkresën e MAPL-së), kurse parafolësi z.Bajram Ajeti kërkoj që të hedhet sërish një dokument tjetër në votim, mirëpo unë pas konsultimeve që kam bërë edhe Grupin e këshilltarëve të PDK-së, por edhe në bazë të asaj që thuhet në dokument do të duhej që Kryesuesi i Kuvendit së bashku me zyrën ligjore të merr bazën ligjore të asaj që prezantoj parafolësi, dhe nëse është bazë e vërtetë ligjore për këtë çështje, të hedhet në votim, nëse zyra ligjore e thotë që kjo bazë nuk është e arsyeshme, nuk do të ishte në rregull nga ana jonë të marrim sërish vendim të jashtëligjshëm, e them këtë ngase z.Bajram Ajeti ceku dispozitat ligjore dhe në fakt çdo Kushtetutë e çdo vendi mbron liritë dhe të drejtat e konsumatorëve.

Çështja tjetër, para marrjes së vendimit të ri, është aplikuar nga KEDS aplikacioni i ri në të cilin nga celulari qysh tani mund të shikohet për çdo ditë sa ke bërë shpenzim të energjisë elektrike, pra është funksionalizuar aplikacioni i ri që ka qenë premtim i KEDS-it. Kështu që ne tani kemi vendimin e Drejtorit të DPUMM për leje pune, kemi dokumentin të cilin a do ta hedh Kryesuesi i Kuvendit në votim dhe a ka bazueshmëri ligjore, si dhe ekziston fakti që 99% e propozimeve sjellën nga Ekzekutivi i Komunës dhe pjesa tjetër prezantohen si propozime nga ndonjë prej subjekteve politike aty këtu. Propozimi në fjalë ka qenë propozim i subjektit LVV, ka kaluar por që është kthyer i jashtëligjshëm, kurse tani nga përfaqësuesi i LVV-së u tha se pika 2 e vendimit është harmonizuar, nëse është ok të hedhet në votim, nëse nuk është, pavarësisht kush është propozues unë personalisht nuk votoj jashtëligjshëm, aty ku e di një gjë të tillë, edhe pse herën e parë nuk e kemi analizuar.

Ministria përkatëse ka kërkuar prej Kryesuesit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës që aktin në fjalë ta harmonizojnë, fjala është për aktin i cili ka kaluar në seancën e fundit, dhe sipas rregullave atë akt duhet ta merr Kryesuesi i Kuvendit ta dërgoj në zyrën ligjore, dhe i njëjti të sjellët si propozim nga Kryetari i Komunës për përfshirje në kuadër të rendit të ditës dhe njëkohësisht të përfshihet në votim. Pra edhe Kryesuesi i Kuvendit nuk mund të merr përgjegjësi që ta hedh në votim nëse nuk ka dispozitë ligjore përkatëse e cila mund të merret si bazë për një gjë të tillë.

Unë edhe përpara por edhe në rastin konkret kam mbështetur kërkesën që konsumatori të ketë qasje në shpenzime, madje e mbështes ende atë vendim, mirëpo i nderuari Kryesues duhet ta dini a keni bazë ligjore, përkatësisht a keni bërë harmonizimin sipas kërkesës së MAPL-së, në mënyrë që ta vëni në votim një dokument të tillë, përndryshe nuk do të ishte mirë as për ju si Kryesues i Kuvendit që të dërgoni sërish të njëjtin vendim në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë sepse do të kthej sërish i jashtëligjshëm. Unë e di se edhe Kuvendi i Kosovës kur ka mëdyshje për akte të tilla i drejtohen

zyrës ligjore, por në rastin tonë nuk di a ka punuar zyra ligjore diçka në këtë drejtim, përkatësisht a ka gjetur dispozitë ligjore për këtë vendim. Pra Kryesuesi të bënë një zgjidhje në mënyrë që ne të dimë si të veprojmë, nëse ka hasur në dispozitë ligjore ta hedh në votim, nëse jo në rregull të vazhdojmë me punë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sot jemi para një akti të MAPL-së sipas të cilit vlerësohet se akti i Komunës i nxjerrë është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Ky vlerësim tregon se ne si organ nuk kemi kompetencë lëndore për rastin e vendosjes së njehsorëve përderisa kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për energjinë elektrike. Në dispozita të këtij ligji është edhe mbrojtja e konsumatorit, është çështja e pajisjeve matëse - matja apo faturimi, si dhe kodi i matjes, pra ky është ligji i cili rregullon problematikën që ne jemi diskutuar. Gjykoj se Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE është organi i cili merret me konteste dhe ankesa në rastet kur ka lexim të gabueshëm të njehsorëve dhe çështjeve tjera, prandaj secili këtu që pretendon diçka jashtë Ligjit për energjinë elektrike, gjykoj dhe me plotë bindje e them se ka karakter politik dhe asgjë më shumë, andaj t'i referohemi ZRRE-së. Ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së kërkojmë që organet ekzekutive të Komunës, t'i parashtrojnë një kërkesë ZRRE-së lidhur me shqetësimet në fjalë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, gjykimet dhe paragjykimet janë vërtetë të dëmshme dhe për ata ne nuk mund të ecim përpara, e them këtë sepse Kushtetuta dhe Ligjet e Republikës së Kosovës nuk janë të LVV-së, por ato rregullojnë një marrëdhënie të një shoqërie mbi të gjithë, për ju, për ne, për ata dhe për të gjithë, prandaj të merret kjo si paragjykim duke thënë se ka diçka me prapavijë politike, është diletantizëm politik. Ne e dimë dhe kemi shqyrtuar edhe rregullën e përgjithshme të ZRRE-së për kushtet e furnizimit, edhe ajo rregull garanton të drejtat e konsumatorëve dhe qytetarëve. Sa i përket asaj që zotëri Llapashtica e tha, unë mund t'i them atij që zyra ligjore e ka pas këtë bazë ligjore, madje para rreth dy ditëve më parë por si duket edhe zyra ligjore e cila është për shërbime profesionale kanë paragjyqime dhe janë të motivuar politikisht, dhe për këtë arsye nuk mund të krijohet diçka profesionale, dhe për këtë arsye dërgohet një vendim pa pazë ligjore, prandaj të mos bëhemi naiv sepse Kushtetuta dhe Ligjet nuk janë as tonat as të juaja. Këtu ne tash ngarkohemi se këtë çështje e kemi për qëllime politike, jo, por ne jemi të vendosur të luftojmë për të drejtat e qytetarëve dhe deri aty do të shkojmë që ndoshta të hyjmë në konflikt administrativ me MAPL-në, dhe pse jo edhe në kushte tonat të rëndësisë tonë ligjore dhe juridike për ta mbrojtur të drejtën e konsumatorit.

Herën e kaluar është sjellë një vendim shumë i pamatur, ju e dini se edhe Kryetari i Komunës ka reaguar qysh në vendosjen e orëve të para në shtylla elektrike, para disa viteve nëse ju kujtohet, kurse sot na dalin dy vendime kontradiktore, përkatësisht dikush që i bënë qejfin KEDS-it, dhe dikush që mbron interesin e qytetarëve, mirëpo dikush duhet të mbroj edhe interesin e KEDS-it por edhe të qytetarit, por gjithmonë duke u bazuar me bazë ligjore, e jo sipas tekeve të individëve apo qejfeve të personave të cilët kanë përgjegjësi për të mbrojtur qytetarët.

z.Avni Islami, theksoi, lidhur me këtë çështje unë personalisht nuk kam ndonjë interpretim, por kam një pyetje për të gjithë ata që janë përgjegjës, a është në kompetencë ose a kemi fuqi juridike ne si Kuvend i Komunës të marrim një vendim të tillë. Nëse kemi pse jo mund të marrim një vendim të tillë, nëse jo atëherë përse po kërkohet një gjë e tillë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuari Kryesues, dokumenti nga MAPL sipas të cilit vendimi në fjalë është i jashtëligjshëm, është dërguar në institucionin e Komunës më 16.05.2019. Nga kjo datë kërkohet që brenda 30 ditëve Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, nëse ka bazë ligjore të harmonizoj dokumentin, pra kështu thuhet në shkresën e Ministrisë e cila është mbikëqyrëse e funksionimit të Komunës, tani a është shikuar dhe a është filluar diçka nga institucioni në këtë proces, është çështje konkrete e tyre. Në këtë aspekt unë mendoj se me 16 qershor 2019 skadon afati

zyrtar i kërkesës së MAPL-së lidhur me detyrën që ka dhënë për Komunën e Podujevës, nëse nuk ndërmerret diçka deri më atë datë, vendimi i Komunës bie nul ngase është vlerësuar i jashtëligjshëm, por nëse gjendet ndonjë dispozitë përkatëse ligjore atëherë unë do të shtroj pyetje përse nuk është harmonizuar ai dokument.

Të drejtat dhe interesat e qytetarëve i mbrojmë të gjithë këtu, por nuk kemi kompetencë të ndalim punët në terren sepse është Drejtoria e Inspeksionit kompetente për këtë çështje, mirëpo për të ngritur dorën për, dokumenti i ri duhet ta përmbaj bazën ligjore, nëse ka të hedhet në votim tani, afati kohor është deri më 16 qershor 2019 për kthimin e përgjigjes, andaj i nderuar Kryesues nëse dokumenti ka bazë ligjore hedhni në votim dhe shihet pastaj kush dhe si voton, por megjithatë kemi dyshime sepse njëherë kemi votuar dhe ka dal që kemi votuar për një vendim të jashtëligjshëm, atëherë përse të besojmë tani që është i ligjshëm e që mund të del sërish i jashtëligjshëm, kështu që paksa jam skeptik në këtë drejtim sa i përket ligjshmërisë, dhe nuk veproj ashtu siç thot një parti politike, vetëm pse thotë ajo, por veproj në baza ligjore, nëse nuk ka e mbyllim këtë temë dhe kalojmë në pika tjera, nëse ka bazë ligjore të hedhet në votim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet rreth kësaj pike të rendit të ditës përfunduan, para vetës keni shkresën e MAPL-së sipas të cilës vendimi përkatës i Kuvendit të Komunës është vlerësuar se është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, afati i rishqyrtimit është 30 ditë, përgjigja duhet të kthehet brenda këtij afati. Prandaj nuk kemi çka tjetër rreth kësaj pike konkretisht rreth vendimit të Kuvendit, unë edhe në fillim të kësaj pike e ceka vlerësimin e ligjshmërisë, andaj nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën e hedh në votim revokimin e vendimit të Kuvendit të Komunës me nr.prot.01-060/01-0030178/19, duke zbatuar shkresën e Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal, nr.prot.020-253/8.

Unë nuk kam hasë askund në ndonjë dispozitë ligjore që një vendim i tillë të kaloj, andaj nuk kam çka të humbi kohë më, por sot duhet të përfundoj kjo çështje sepse ashtu edhe kërkohet, kurse kërkesa tjera nuk i marrë parasysh, vlerësimi është shumë i kurtë, kush dëshiron ta kuptoj.

z.Bajram Ajeti, theksoi, po mendoj se kemi ardh në një situatë jo të mirë, ne si assemble kemi një vendim i cili është dërguar në MAPL për mbikëqyrje ligjore, kështu që unë mendoj se do të ishte më e drejtë që ky Kuvend të obligoj zyrën ligjore që vendimin e kthyer nga MAPL ta nxjerrë në baza ligjore sepse ne jemi shumë të bindur dhe shumë të vendosur se baza ligjore ekziston për këtë vendim. Dikush mendon se përmes telefonave mund të shohësh shpenzimet e energjisë elektrike, mirëpo një ndër elementet kryesore është çështja e sigurisë është elementi themelorë rreth çështjes së njëhësorëve të vendosur nga KEDS në shtylla të energjisë, element të cilin duhet ta marrim parasysh. Mendoj që vendimi paraprak të mbetet në fuqi por të plotësohet me bazën ligjore që unë besoj se do të jetë e bindshme edhe për MAPL-në dhe për çdo institucion tjetër të kësaj fushe, qoftë edhe institucione tjera të drejtësisë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, paraprakisht u konsiderua se diskutimet rreth kësaj teme përfunduan, dhe njëkohësisht paraqita një rezymë rreth kësaj pike.

Kemi një vlerësim të ligjshmërisë nga Ministria përkatëse rreth këtij vendimi, sipas të cilit unë personalisht konsideroj se është kërkuar revokimi i vendimit të Komunës, tani jemi në procesin e votimit, andaj kusht është për revokimin / anulimin e vendimit nr.prot.01-060/01-0030178/19.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se me 18 vota për, 11 vota kundër, asnjë votë e përmbajtur, (të tjerët nuk votuan fare), miratohet revokimi/anulimi i vendimit nr.prot.01-060/01-0030178/19 që kompanisë private KEDS i ndalohej vendosja e njëhësorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

4. Propozim Vendimi për vëni në diskutim publik:

- **Propozim Rregullore për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës**
- **Propozim Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës**

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, në emër të Grupit punues për hartimin e këtyre dy draft rregulloreve dëshiroj të prezantoj para Kuvendit draftet fillestare të cilat kërkohet të vëhen në diskutim publik, fjala është për propozim Rregulloren për mbrojtjen e mjedisit, dhe propozim Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave. Pra kemi propozim vendimin përkatës për vënie në diskutim publik të dy dokumenteve të cekura, pikë kjo e cila ka hyrë si pikë shtesë në mbledhjen e KPF-së dhe i është rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Për arsye të zënies së afateve kohore, përkatësisht që diskutimi publik të mos jetë gjatë periudhës së pushimeve verore, kërkohet nga Kuvendi i Komunës që të miratohet propozim vendimi sipas të cilit draftet në fjalë nxjerrën në diskutim / debat publik, ku brenda një muaji të gjithë qytetarët e interesuar dhe të gjitha palët e interesit të mund të japin kontributet e tyre në formë të komenteve, sugjerimeve, propozimeve apo edhe vërejtjeve eventuale.

Para se të mbahen debatet publike, Grupi punues edhe njëherë do të takohet dhe do të analizoj draftet e rregulloreve në fjalë, me qëllim që të shikohen edhe njëherë për lëshime teknike, gjuhësore apo lëshime tjera eventuale, mirëpo me rëndësi është që të miratohet propozim vendimi në fjalë që pastaj draftet e cekura t'i nënshtrohen diskutimit dhe debateve publike dhe të kenë mundësi të pasurohen me komente, sugjerime dhe propozime nga ana e qytetarëve, dhe krejt në fund të bëjmë përpjekje që draftet finale të paraqiten në seancën e radhës së Kuvendit, para pushimeve, për miratim.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së parimisht e mbështetë marrjen e vendimit për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për mbrojtjen e mjedisit dhe propozim Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave. Meqë në nenin 3 të propozim vendimit theksohet se sugjerimet dhe propozimet paraqiten në ditën e mbajtjes së debatit publik, ne do t'i paraqesim në debat, mirëpo rreth debateve publike shpresoj të kemi një strategji për të ftuar qytetarët në mënyrë që të kontribuojnë në hartimin e rregulloreve, e jo debatet publike të kryhen vetëm minimalisht me një numër të vogël të qytetarëve pjesëmarrës, pasi që Komuna për debate publike bënë thirrje vetëm përmes faqes zyrtare të Komunës dhe nëpërmes rrjeteve sociale të cilat nuk shpërndahen fare. Pra në performancë komunale bënë pjesë edhe transparenca komunale do të ishte mirë të mos dalim të barazuar me Komunën e Shtërpçës.

Kryesuesi i Kuvendit, nënvizoj, krahasimi që bëri parafolësja nuk më pëlqeu paksa, mirëpo është çështje e juaja kjo.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së përkrahim propozim vendimin që dy propozim Rregulloret në fjalë të vëhen në diskutim publik, kurse sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet tona do t'i paraqesim gjatë diskutimit / debatit publik.

Nëse do të mund të paraqiteshin datat e diskutimit publik dhe debatit publik me qytetarë.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, edhe pse në konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së është cekur kohëzgjatja e diskutimit dhe debatit publik me qytetarë, unë të njëjtat sërish do të paraqes, si vijon;

Për propozim Rregulloren për mbrojtje të mjedisit, afati i diskutimit publik është 30 ditë, nga 03 qershor deri më 03 korrik 2019, ndërsa debati publik me qytetarë është caktuar të mbahet më 17 qershor 2019 në këtë sallë të Kuvendit në orën 10:00.

Për propozim Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, afati i diskutimit publik është i njëjtë, 30 ditë, nga 03 qershor deri më 03 korrik 2019, ndërsa debati publik me qytetarë është caktuar të mbahet më 18 qershor 2019 në këtë sallë të Kuvendit në orën 10:00.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, e hedh në vitim propozim vendimin për vënie në diskutim publik dy propozim Rregulloret sipas materialit përkatës, dhe konstatimeve nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet propozim vendimi për vënie në diskutim publik të:

- **Propozim Rregullore për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës**
- **Propozim Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës**

Duke përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht;

-Për propozim Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës, diskutimi publik zgjat 30 ditë përkatësisht prej nga 03.06.2019 deri më 03.07.2019, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më 17.06.2019 në orën 10:00.

-Për propozim Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës zgjat 30 ditë përkatësisht prej 03.06.2019 deri më 03.07.2019, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më 18.06.2019 në orën 10:00.

5. Të ndryshme

z.Arbër Blaku, theksoi, i nderuari Kryesues i Kuvendit, po bëhen dy vite nga mandati i këtij Kuvendi dhe ne si këshilltarë të paktën nga një ID kartelë nuk e kemi.

Çështja tjetër ka të bëjë me blerjen e Llaptopëve për këshilltarët e Kuvendit, çështje për të cilën është publikuar tenderi, por pyetja ime është se a ka zyrë të IT-së apo jo, kur e them këtë e kam parasysh që zyrtarin Rrahim Berisha e njoh personalisht, por habitem kur shoh specifikat, madje mund të bëjë një krahasim, të kërkohej golf 4 i ri në vitin 2019 nuk gjen sepse nuk ka. Konsideroj se specifikacionin e tenderimit që është bërë është për marre, dhe për këtë pastaj dështon edhe projekti, madje me të njëjtat specifika do të dështoj sa herë që ta publikoni. Nëse dëshironi asistencë, urdhëroni ju jap sepse jam profesionist në këtë fushë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, rreth asaj që parafolësi e tha unë do të bëjë përpjekje maksimale për këto gjëra, por kushtet buxhetore janë këto që janë, specifikacioni ekziston dhe do të shikojmë më në detaje se deri ku ka shkuar procedura. Edhe për ID kartela do të pyes Drejtorin e Drejtorisë përkatëse dhe do t'ju informoj.

z.Fatmir Rudari, theksoi, kam pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Administratës, çështja ka të bëjë me Rregulloren për bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, draft i cili ka pothuajse 1 vit prej që ka dalë në diskutim publik dhe ende nuk është sjellë në Kuvend për shqyrtim dhe miratim final duke përfshirë edhe raportin i diskutimit publik.

Pra kërkoj sqarim nga Drejtori në fjalë, sepse ai ka qenë si përgjegjës rreth kësaj çështje.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, rreth çështjes së cekur nga parafolësi z.Fatmir Rudari, ju njoftoj se jemi duke përgatitur Hartën Zonale me të cilën do të ndahen edhe disa pjesë, andaj edhe

kjo është njëra prej arsyeve që nuk kemi mund ta sjellim në Kuvend Rregulloren e cekur, por besoj që në seancën e radhës ka mundësi të procedohet për Kuvend.

znj.Floreta Zejnullahu, theksoi, pas takimeve të shumta që kam pasur me banorët e fshatit Lladoc, sidomos me të rinjtë dhe të rejtat e fshatit, sot paraqes para juve një kërkesë që ka rezultuar nga bashkëbisedimi. Është shumë e nevojshme ndërtimi i një fushe të sportit në fshatin Lladoc pasi që eksitojnë disa parakushte që mundësojnë një gjë të tillë, së pari për ndërtimin e një fushe të sportit ekziston hapësira ose toka ku do të ndërtohej fusha, që është pronë komunale e pashfrytëzuar deri sot, së dyti, ndërtimi i një fushe do të mundësonte që të rinjtë e fshatit të kenë një adresë për zhvillimin e aktiviteteve sportive duke mundësuar edhe një socializim më të mirë mes tyre dhe parandalimin e mundësive për zhvillimin e dukurive negative dhe sjelljeve devijante tek të rinjtë, së treti, në fshatin Lladoc nuk ka asnjë fushë të sportit të ndërtuar dhe është shumë e nevojshme ndërtimi i një fushe të hapur sportive.

Duke marrë parasysh se kërkohet të procedohet si kërkesë me procedura të rregullta, unë kërkesën time bashkë me nënshkrimet e banorëve do ta dorëzoj në adresën përkatëse, ndërsa kërkoj që të mbështetet kjo kërkesë dhe të shtyhet para për realizimin e saj, nëse këtë vit nuk ka buxhet të planifikuar, kërkoj që të përfshihet si projekt i planifikuar për vitin e ardhshëm, si dhe njëkohësisht pres sqarim nga Drejtori z.Hamdi Jaha, nëse një gjë e tillë është e mundshme.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit duke uruar Festën e Bajramit të gjithëve, e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0043554/19
Podujevë,
31 maj 2019

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi